



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Drejtoria Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve
Sektori i Transparencës dhe Komunikimit

Lënda : *Minutat e takimit për draft vendimin e Këshillit të Ministrave “Për rregullat, përgjegjësitë dhe procedurat e detajuara për VSM-në në kontekstin ndërkufitar”*

Ditën e martë datë, 03.01.2015, në ambjentet e Ministrisë së Mjedisit u zhvillua dëgjesa e publikut për draft vendimin e Këshillit të Ministrave “Për rregullat, përgjegjësitë dhe procedurat e detajuara për VSM-në në kontekstin ndërkufitar”

Në këtë takim merrnin pjesë këta përfaqësues:

Z. Arben Lici, ECA Studio Konsulent;

Z. Qerim Ismeni, Shoqata Mjedisore për zhvillim të qëndrueshëm Rajonal

Z. Elton Qëndro, OSCE , prezenca në Shqipëri.

Nga Ministria e Mjedisit ishin këta përfaqësues:

Z. Redi Baduni, Drejtor i Mjedisit

Znj. Madalena Koja, Përgjegjëse e Sektorit të Legjislacionit

Znj. Ornela Shoshi, përgjegjëse e Sektorit të VSM-së, VNM-së Standarteve Mjedisore dhe të Aksidenteve Industriale

Znj. Enkelejda Malaj, përgjegjëse e Sektorit të Sektorit i Transparencës dhe Komunikimit

Znj. Borana Andoni, specialiste e Sektorit të VSM-së, VNM-së Standarteve Mjedisore dhe të Aksidenteve Industriale

Znj. Edlira Dersha, specialiste, Sektorit i Transparencës dhe Komunikimit

Znj. Ilda Shahu specialiste e Sektorit të VSM-së, VNM-së Standarteve Mjedisore dhe të Aksidenteve Industriale

Dëgjesa u hap nga z. Redi Baduni, i cili shprehu rëndësinë e kësaj dëgjese për të ndihmuar procesin e hartimit të legjislacionit mjedisor e në veçanti të këtij draft Vendimi të Këshillit të Ministrave “Për rregullat, përgjegjësitë dhe procedurat e detajuara për VSM-në në kontekstin ndërkufitar”

Më pas z. Baduni ja dha fjalën znj. Borana Andoni, e cila bëri një prezantim të këtij draft vendimi.

Znj. Andoni bëri një prezanti të rëndësishme së hartimit të këtij projektakti, qëllimi i të cilit është krijimi i procedurave të detajuara për VSM-në në kontekstin ndërkufitar. Ky akt synon të përcaktojë rregulla dhe kritere për të vlerësuar nëse:

- ✓ Planet apo programet e propozuara kërkohen të zbatohen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë do të kenë ndikime mjedisore në shtetet fqinje
- ✓ Rregulla dhe procedura që do të ndiqet nga vendi ynë në raste të tilla;
- ✓ Organizimin e vlerësimeve ndërkufitare rregullimet institucionale, administrative etj të këtij procesi.

Më pas znj. Andoni prezantoi më në detaj 6 krerët e këtij vendimi.

Në fjalën e tij z. Qerim Ismeni, kërkoi të dinte nëse gjatë zhvillimeve të këtyre projekteve madhorë që kërkohet Vlerësim Strategjik a do merreshin për bazë që në faza të herëshme, marrëveshjet që mund të kenë shtetet me njëri tjetrin në fusha që kanë lidhje me këtë aktivitet.

Z. Baduni siguroi z. Ismeni që këto procedura padyshim që marrin parasysh çdo marrëveshje apo legjislacion që egziston nga të dy vëndet, ku do shtrihet ndikimi që sjell plani apo programi i ndërmarrë.

Z. Elton Qëndro, përfaqësuesi i Prezencës së OSCE-së në Shqipëri, komentoi afatin e njoftimit fillestar të autoritetit propozues dhe palës së prekur Kreu II pika 6, ku i lihet një afat prej 20 ditësh pune.

Të gjithë ranë dakort që koha e vënë në dispozicion ishte shumë e shkurtër dhe nuk mund t'i përgjigjej realitetit. Znj. Ornela Shoshi u shpreh se do e rishihnin dhe njëherë këtë afat.

Më pas z. Arben Liçi, bëri këto komente mbi draftin e vendimit:

Riparja edhe njëherë e legjislacionit, pasi është hequr termi strategji, ndërkohë që në vendin tonë hartimi i strategjive është një proces shumë i shpeshtë për të gjitha fushat.

Znj. Shoshi u shpreh se nuk është e mundur në këtë moment të bënim një riparje të ligjit, ndaj termi strategji nuk është e mundur të futet në këtë akt nënligjor.

Të rishihet dhe njëherë termi “palë e prekur”, pasi kjo shprehje pragjykonte në njëfarë mënyre procesin.

Znj. Madalena Koja së bashku me znj. Shoshi, ju shpjeguan të pranishmëve që ky term është term i pandryshueshëm, pasi është i tillë dhe në definicionin që jep ligji nr 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor” për palën që ndikohet apo mund të ndikohet nga hartimi i një plani apo programi.

Gjithashtu z. Liçi sygjeroi të shihej dhe njëherë formulimi i fjalive në Shtojcën II të projekt vendimit.

Për këtë ranë dakort të gjithë.

Znj. Ornela Shoshi ju shpjegoi të pranishmëve që Direktivat janë gjithmonë të përgjithshme, por ky draft vendim mundëson krijimi i procedurave të detajuara për VSM-në në kontekstin ndërkufitar, procedura që do i zbatojnë entet shtetërore në planet dhe programet që do të hartojnë në të ardhmen.

Takimi u mbyll duke u kërkuar nga përfaqësuesit e organizatave që minutat e këtij takimi do të qarkulloheshin.